



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-5697/1 datë 08.06.2022, NDËRPRITET
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-5697 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5697/1 të datës 20.07.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për pagesë të dyfishtë të shtesave për punë të personit zyrtar ///, këshilltar /// drejtor në ///. Ky zyrtar, sipas pretendimeve në denoncim, përveç pagës si drejtor i /// së lartpërmendur, njëkohësisht ka marrë kompensim nga ///, për ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente, të dhëna, informacione dhe dokumentacion nga Ministria e Kulturës e RMV-së dhe nga këqyrja e kërkesës së dorëzuar, rezulton se pretendimet e paraqitura në denoncim janë të pabazuara. Gjegjësisht, personi i cekur në denoncim ka kryer funksionin e drejtorit të /// së lartpërmendur, nga viti /// deri në vitin ///. Gjatë gjithë mandatit, Ministria e Kulturës e RMV-së thekson se atij nuk i janë paguar shtesa, në asnjë bazë. KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së
Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev

